



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT
TIRANE

Bulevardi "Zhan D'Ark" Tirane, Shqiperi Tel/Fax 00 355 04 2260284

Nr. 12 Prot.

Tirane, më 20.01.2015

URDHËR

**“MBI GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE PENALE NGA KOLEGJET CIVILE
GJATË MUAJIT MARS 2015”**

Në mbështetje të Ligjit nr. Nr.9877, date 18.2.2008 “Per Organizimin e Pushtetit Gjyqësor :
Republikën e Shqipërisë”, neni 18, dhe

Per shkak se:

- *ka nje numer te madh te ceshtjeve penale te regjistruara ne Gjykatën e Apelit Tirane;*
- *afatet kohore te gjykimit te ceshtjeve penale jane te prekluzive, me pasoja per gjykimin
penale;*
- *dy kolegjet penale te kesaj gjykate, nuk mund ta perballojne kete ngarkese,*

si dhe mbas diskutimit te bere ne mbledhjen e mengjesit te dates 19.01.2015,

URDHËROJ:

1. Nga data 1-31 Mars 2015, gjyqtarët e kolegjeve civile do të gjykojnë çështje penale të hedhura në short ndërmjet tyre, krahas çështjeve civile që janë në proces gjykimi, duke plotësuar këtë mënyrë numrin e dosjeve për çdo gjyqtar sipas praktikës së punës.
2. Çështjet penale që do të marrin në shqyrtim gjyqtarët e kolegjeve civile janë çështjet regjistruara pranë Gjykatës së Apelit Tiranë gjatë muajit Janar 2015.
3. Për plotësimin e normës mujore të gjykimeve për çdo gjyqtar, do të merren çështje penale në dy kolegjet penale, të cilat janë regjistruar në muajt Nëntor dhe Dhjetor 2014 dhe do të hidhen në short ndërmjet të gjithë gjyqtarëve civilistë.
4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen: Kancelari z. Arbër Kushe, Kryesekretarja Zj. Fl. Shakaj, si dhe Specialistët e IT zj. Elvira Pitarka e z. Erlin Hajdini.
5. Ky urdhër të publikohet në këndin informativ të Gjykatës dhe faqen e internetit me qëllim informimin e publikut lidhur me këtë ndryshim të përkohshëm.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ALAUDIN MALAJ